



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2018:015802

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05746147

P.nr.201/18

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA NË KAÇANIK, Departamenti I Pergjithshem, Divizioni Penal, gjyqtarja Zajrete Muhaxheri me bashkëpunëtorin profesional Ismajl Kuçi, në lëndën penale, ndaj të pandehurve: E. R. nga fsh...-Kaçanik dhe V. Q. nga fsh...-Kaçanik, për shkak të veprës penale në bashkryerje, Vjedhja nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-se, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.nr.770-3/18 të datës 25.04.2018, jashtë shqyrtimit gjyqësor, më datë 28.05.2024 mori këtë

A K T V E N D I M

Ndaj të pandehurve:

1.E. R. nga fsh.Runjevë-Kaçanik, I lindur me dt... nga I ati S. dhe e ëma F., e gjinisë, Limani, shqiptar, shtetas I Rep. së Kosovës, I martuar, ka të kryer shkollën fillore, I gjendjes së dobët ekonomike, me nr.personal:

2. V, Q. nga fsh.Rekë-Kaçanik, I lindur me dt... nga I ati Sh. Dhe e ëma H., e gjinisë, Beqiraj, shqiptar, shtetas I Rep. së Kosovës, kë të kryer shkollën e mesme, I gjendjes së mesme ekonomike, me nr.personal:....

HUDHET Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.nr.770-3/18 e datës 25.04.2018, për shkak të veprës penale, Vjedhja në bashkryerje, nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-se, për shkak se është shkaktuar ndalesa absolute për ndjekje penale.

E dëmtuara, kompania “Bechtel Enka” me seli në Prishtinë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës bijnë në ngarkim të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, ka ngrit aktakuzën PP.nr.770-3/18 të datës 25.04.2018, kundër të pandehurve: E. R. nga fsh...-Kaçanik dhe Valon Qorri nga fsh...-Kaçanik, për shkak të veprës penale në bashkryerje, Vjedhja nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-se.

Gjykata konstatoi se vepra penale, Vjedhja në bashkryerje nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, është kryer me dt.03.04.2018.

Sipas nenit 106 par.1 nënpar.1.5 të KPK-së, (04/L-082), për veprën penale, Vjedhja në bashkryerje, nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, është paraparë afati i parashkrimit prej 3 vite, ndërkaq sipas nenit 107 par.8 të KPK-së, është paraparë se ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së parashkrimit.

Prandaj në bazë të kësaj, gjykata konstatoi se për veprën penale, Vjedhja në bashkryerje nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, me dt.03.04.2024, ka arritur afati i parashkrimit.

Meqë nga dita e kryerjes së veprës penale dhe ditës së marrjes së këtij aktvendimi kanë kaluar më tepër se gjashtë vite, gjykata ka gjetur se ekzistojnë shkaqet për hudhjen e aktakuzës sepse është shkaktuar parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit në contest civil u mor konfor nenit 462 par.2 të KPP-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 449 të KPP-së.

Nga sa u tha u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi

.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEGA KAÇANIK

P.nr.201/18 datë 28.05.2024

Bashkpunëtori profesional

Ismajl Kuçi

Gjyqtarja,

Zajrete Muhaxheri

Këshilla juridike: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimet. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj Gjykate.